



## THIRRJE PËR APLIKIM PËR GRANTE TË VOGLA

Përveç rrezikimit të shëndetit publik, pandemia COVID-19 në mënyrën disproporcionale po dëshmon t'a afektojë mirëqenien sociale në Kosovë. Duke marrë parasysh situatën aktuale socio-ekonomike të grave, kriza shëndetësore ka potencialin për të përkeqësuar pabarazitë ekzistuese gjinore në Kosovë përderisa gratë në tregun e punës janë më të cenueshme ndaj pasigurisë së krijuar ekonomike. Andaj, D4D ju fton të aplikoni me propozime emergjente për grante të vogla për të lehtësuar gjendjen e krijuar.

Qëllimi i këtyre granteve është avokimi për rritjen e qasjes së grave në tregun e punës në nivelin lokal si dhe qëndrueshmërinë në tregun e punës pas COVID-19. Organizatat e përzgjedhura, do të përfitojnë poashtu edhe mbajtjen e një trajnimit përmes platformës online për ngritjen e fondeve dhe avokimit.

### KUSH MUND TË APLIKOJË?

1. OJQ-të e grave në nivel lokal dhe shoqatat me përvojë në adresimin e qasjes së grave në tregun e punës;
2. Entitetet e grave (formale dhe jo-formale) që adresojnë qasjen e grave në tregun e punës në nivel komunitar;
3. Organizata ose subjekte të drejtuara nga gratë vullnetare;

Projektet/iniciativat e pranueshme për financimin e granteve përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

1. Avokimi në nivel lokal për ndryshime të caktuara të rregulloreve që rrisin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi qasjen e grave në tregun e punës pas ndikimit nga pandemia Covid-19;
2. Lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe shoqatave të sipërmarrësve të udhëhequra nga gratë dhe/ose ndërmarrjeve sociale të grave, kooperativave;
3. Forcimi i kapaciteteve të grave të tjera përmes ofrimit të informatave për trajnime, iniciativa për ngritjen e kapaciteteve dhe shkathtësive të tjera të punës;
4. Lehtësimi i qasjes në informacione dhe burime të tjera në lidhje me rimëkëmbjen ekonomike;
5. Analiza hulumtuese për situatën e grave në Kosovë gjatë pandemisë (ekonomike dhe sociale);
6. Partneritetet që përfshijnë anëtarë të autoriteteve vendimmarrëse (psh. Kuvendin Komunal) dhe gratë në nivel lokal.

**Shënim:** Një aplikacion duhet të përputhet me kriteret e caktuara në thirrje për të vazhduar në fazën e vlerësimit. Aplikacionet që nuk respektojnë rregullat e thirrjes, do të refuzohen. Vendi dhe kohëzgjatja e propozuar përfshinë shtatë regjionet e Kosovës (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan). Aktivitetet duhet të implementohen brenda periudhës prej maksimum 2 muajve prej datës që granti fitohet. Të gjitha aktivitetet duhet të mbahen në përputhje me masat dhe vendimet e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës në lidhje me pandeminë COVID-19.



[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

**Democracy for Development**  
**Demokraci për zhvillim**  
**Demokratija za razvoj**

## KRITERET E VLERËSIMIT

Të gjithë pjesëmarrësit do të vlerësohen mbi potencialin e projektit për të pasur një ndikim të prekshëm në rritjen e qasjes të grave në tregun e punës në nivel lokal komunal. Secili projekt do të vlerësohet në bazë të kriterëve të mëposhtme të përzgjedhjes:

### 1. Qasja teknike

- Relevanca e nevojave dhe çështjeve të adresuara;
- Kualiteti i aktiviteteve të propozuara;
- Akvitetet e orientuara drejt rezultateve;

### 2. Kapacitetet organizative/grupore

- Kapacitetet organizuese dhe administrative
- Përvoja relevante dhe rezultatet në fushat e ngjashme;

### 3. Propozimi i kostos/shpenzimeve

- Buxheti i shfrytëzuar mirë/në mënyrë efektive

## DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOHEN

- Një propozim i shkurtër i projektit, që përshkruan qëllimet dhe objektivat kryesore të projektit dhe rezultatet përfundimtare;
- Një buxhet i propozuar që do të përdoret në mënyrë efektive në përputhje me objektivat dhe rezultatet e projektit.
- Dokumentet ligjore që sigurojnë regjistrimin e organizatës (në rastin e OJQ-së);
- Nëse është relevante, dëshmi e kompetencës dhe eksperiencës dhe mëparshme në aktivitetet relevante.

## NIVELET E FINANCIMIT

Organizatat e grave/entitetet janë të ftuar të aplikojnë për një grant prej **1,300 euro**. Ju lutem vini re se mbështetja financiare e kërkuar nuk duhet të tejkalojë shumën maksimale të grantit. Shpenzimet administrative nuk duhet të kalojnë 5% të shumës së përgjithshme.

## DATAT E APLIKIMIT

Data e fundit për aplikim është **01 shtator 2020**, deri në **17:00** në e-mail adresën [grants@d4d-ks.org](mailto:grants@d4d-ks.org)

Mirëpresim aplikimet e juaja, dhe jemi në dispozicion për t'u përgjigjur në çdo pyetje apo paqartësi që mund të kenë.

Sinqerisht,  
Instituti D4D

*Thirrja për grante të vogla është pjesë e projektit “Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës” mbështetur nga “The Balkan Trust for Democracy” (BTD).*